

PROF. BAHRI ALIU
Specialist i mësimit Islam

**MEDRESJA ISA BEU
VATËR E ARSIMIMIT DHE E EDUKIMIT
TË GJENERATAVE TË DIKURSHME, TË SOTME DHE TË NESËRME**

Medrese¹ në kuptimin etimologjik don të thotë shkollë, ndërsa në kuptimin terminologjik don të thotë vend apo institucion ku mësohen dituritë Islame.²

Mësimi në formë të organizuar, mund të themi edhe si formë institucionale, është zhvilluar gati prej ditëve të para të Shpalljes Kur'anore. Edhe pse në këtë kohë është zhvilluar në mënyra krejt të tjera nga këto të sotmet, është e rëndësishme të thuhet se fillesat e shkollimit datojnë që nga ditët e para të Islamit. Këtë e dëshmon rasti i Betejës së Bedrit³ kur muslimanët robëruan një numër të konsiderueshëm nga pala e mushrikëve – kundërshtarëve. Ushtarët e robëruar mund ta shpague veten, po që se u mësonin shkrim lexim dhjetë muslimanëve.

Medresetë gjatë historisë përjetojnë zhvillimin e vet në kuptime të ndryshme. Në vendet Islame medreseja gjithmonë ka qenë dhe është vendi ku përgatiten kuadro për profile a drejtime të ndryshme. Them të ndryshme, sepse me termin medrese tek muslimanët kuptohet shkollimi në të gjitha lëmitë, qofshin ato fetare ose profane. Ndarja e mësimit bëhet shumë vonë; me sa duket, i ka fillesat nga kolonialistët e imperialistët që deshën t'i paraqesin muslimanët si armiq të shkencës, diturive profane dhe, sikur muslimanët janë të krijuar nga Zoti vetëm për t'u munduar në këtë botë e se

¹ Dr. Isa Memishi, Fjalor arabisht-shqip I, Prishtinë 2011

Teufik Muftić, Arapsko-srpskohrvatski rječnik I, Sarajevo 1973.

² Ndreca Mikel, Fjalor fjalësh e shprehjesh të huaja, Rilindja – Redaksia e botimeve Prishtinë, 1986.

³ السيرة النبوية لابن هشام, الطبعة الثانية 1375 هـ - 1955 م.

përpiqen vetëm që të fitojnë Ahiretin, jetën e amshueshme. Kuptimi i fjalës medrese si vend ku jepet mësim fetar u përkufizua vetëm nga politikanët e bllokut socialisto-komunist. Fenë, sipas tyre, duhet ta mësojë vetëm besimtari, ndërkaq, gjithçka që ka të bëjë me këtë botë, është në kundërshtim me aspektet fetare, andaj edhe tek ne, sot e kësaj dite bëhet një ndarje e padrejtë e shkencës në fetare dhe profane, laike. Këtë nuk e them rastësisht, por, sepse po që se konsultojmë një fjalor të fjalëve dhe shprehjeve të huaja rreth termit medrese do të hasim këtë kuptim të ngushtë, që është në kundërshtim me të vërtetën e fjalës.

P. sh., në Fjalorin e fjalëve e shprehjeve të huaja nga Mikel Ndreca, botim i Rilindjes, në vitin 1986, hasim: **“Medres/e – ja (ar. Madrasa – vend ku jepet mësim; tur. Medrese) shkollë e mesme ose e lartë fetare myslimane për të përgatitur hoxhallarë e myderizë.**

Ngjashëm e gjejmë edhe te Fjalori i fjalëve dhe shprehjeve të huaja i Vujaklisë dhe Kllajiqit të njohur tek ne.⁴ Pa e zgjatur shumë këtë shtjellim, tani, në fillim të mileniumit të tretë, njeriu në mënyrë objektive po i qaset problemeve shkencore, pa i kufizuar negativisht, siç ngjau gjer më tani.

Shkollimi tek muslimanët qysh herët ka qenë i shkallëzuar. Këtë e vërtetojnë emrat e shkollave tradicionale, si:

Mekteb⁵ – është quajtur shkolla fillore,

Medrese ose ruzhdije⁶ – është quajtur shkolla e mesme dhe

Xhami’a⁷ – është quajtur shkollimi universitar dhe pasuniversitar.

Këto emërtime në kuptim të përgjithshëm kanë ngelur edhe sot e kësaj dite.

Me përhapjen e Islamit në botë, muslimanët, pavarësisht se ku gjendeshin, morën gati të njëjtën formë shkollimi e në këtë kuadër edhe muslimanët e

⁴ Bratoljub Klaić, Rječnik stranih riječi, Nakladni Zavod MH, Zagreb 1984.

⁵ Po aty.

⁶ Tahir N. Dizdari, Fjalor i orientalizmeve në gjuhën shqipe, AIITC dhe ISESCO, Tiranë 2005.

⁷ المنجد في اللغة والأعلام , المكتبة الشرفية , بيروت 1960

Ballkanit, gjatë prezencës së osmanlinjve në trojet tona, përdornin të njëjtat emërtime të cikleve të shkollimit, mbase me ndonjë përjashtim.⁸

Ndër aktivitetet me të cilat u mor Perandoria Osmane në Ballkan dhe në vendet e tjera që administronte, ishte edhe hapja e medreseve.⁹ Forma më e njohur dhe më produktive e shkollimit ka qenë me shkolla private, që themeloheshin në emër të vakufëve, por edhe të themeluesve të tjerë. Kështu, tek ne janë të njohura medresetë e vjetra, si: medreseja e Isa Beut në Shkup, medreseja e Gazi Husref Beut në Sarajevë, Medreseja e Alaudinit në Prishtinë, medreseja e Sheh Shamisë në Shkodër etj.

Në vendet tona kanë punuar edhe medrese të tjera, të cilat kryesisht kanë mbajtur emrin e hoxhës që i ka organizuar ose mbikqyrur. Shkollimi apo mësimi i tillë zhvillohej me përcaktime konkrete të talebeve, nxënësve. Nxënësi që dëshironte të studionte, duhej të kërkonte fillimisht hoxhën, arsimtar që do ta pranonte dhe, pasi të kryente ciklin e shkollimit, të merrte titullin kualifikues. Shkollat e këtij lloji janë quajtur mektebe.

Me rënien e Perandorisë Osmane,¹⁰ në trevat tona, si duket, kanë vepruar mektebet e këtij lloji. Njëherit, me ndryshimet në sistemin politik dhe regjimin shtetëror mektebet e këtilla kanë vepruar edhe në formë ilegale, sepse sistemet shtetërore nuk i lejonin të punojnë.

Në kuadrin e medreseve në trojet tona, sot do flas më gjërësisht për Medresenë e Isa Beut.

Medreseja “Isa Beu” ndjek traditën e medresesë së dikurshme “Isa Beu” e themeluar në fillimin e shekullit XV. Medreseja e atëhershme merr emrin sipas themeluesit të saj Isa Beut, djali i Is’hak Beut.¹¹ Në atë kohë medresja “Isa Beu” paraqiste institucionin më të lartë arsimor. Krahas medresesë

⁸ Gliša Elezović, Staroosmanski sponeci u Skoplju, separat pa vit botimi.

⁹ Bajrush Ahmeti, Historia Islame 4, Medresja e mesme “Alaudin” – Prishtinë, Prishtinë, 1996

¹⁰ Dr. Ali Muhamed Salabi, Perandoria Osmane – faktorët e ngritjes dhe të rënies së saj, Prishtinë 2009.

¹¹ Po aty.

ekzistonte xhamia dhe biblioteka me të njëjtin emër. Në krahasim me shkollat e tjera, kjo ishte shkolla më e madhe në atë kohë në Maqedoni, madje është më e vjetër se medresja e “Husref Beut” në Sarajevë. Prej kohës së themelimit e deri më tani përjetoj ca ndërprerje në punën e saj, ndaj edhe është meremetuar disa herë. Ndërprerja e parë ndodhi në vitin 1689 kur u dogj qyteti i Shkupit nga Pikolomini – komandant i ushtrisë Austro-hungareze. Mbeturinat e medresesë janë ruajtur deri para Luftës II Botërore. Ajo ka qenë vakuf siç është edhe e sotmja. Pas Luftës I Botërore, u rikonstrua në vitin 1932, ndërsa inagurimi u bë në vitin 1936. Mirëpo, me fillimin e Luftës II Botërore, rreth vitit 1941, puna u ndërpre. Në Jugosllavinë e vjetër në këtë medrese shkolloheshin nxënës nga Kosova, Sanxhaku, Serbia Jugore dhe Maqedonia. Në medresenë e paraluftës krahas lëndëve fetare mësoheshin edhe lëndë shkencore.

Nisur nga këto të dhëna dhe nga nevoja kadrovike e organizatës së Bashkësisë Islame në Maqedoni, në vitin 1978 për herë të parë lindi ideja për ndërtimin a rindërtimin e një medreseje të mesme në Shkup. Në vitin 1979, në mbledhjen e Kuvendit të Bashkësisë Islame të Jugosllavisë¹² u vendos që të fillojnë aktivitetet rreth përgaditjes së dokumentacionit të nevojshëm prej organeve shtetërore e politike. Kështu, më 17 Ramazan të vitit 1980 vendoset gurthemeli i kompleksit të medresesë “Isa Beu”.¹³ Mirëpo, për shkak të mungesës së mjeteve financiare, punimet u ndërpre deri nga pranvera e vitit 1982, kur përsëri në mënyrë intensive vazhduan punimet rreth kompleksit në fjalë. Falë ndihmës dhe angazhimit maksimal të besimtarëve të Republikës së Maqedonisë brenda 14 muajve përfunduan punimet ndërtimore dhe me 15 tetor të vitit 1984 në mënyrë solemne e madhështore filloi puna edukativo–arsimore në medresenë e re. Pra, meritë e madhe për ndërtimin e këtij objekti u takon besimtarëve të trevave të Maqedonisë të cilët ndanë nga goja kafshatën e bukës, vetëm e vetëm që të

¹² Nga arkivi i Bashkësisë Islame – Shkup.

¹³ Nga arkivi i SHMI “MEDRESJA ISA BEU” – Shkup.

hapet kjo çerdhe e arsimit fetar e shkencor. Kompleksi i medresesë “Isa Beu” shtrihet në fshatin Kondovë në afërsi të Shkupit në sipërfaqe prej 7000 metër katrorë, prej të cilave 3000 metër katrorë janë nën kulm. Kompleksi përbëhet prej tre objekteve:

- **Ndërtesa e shkollës** që ka gjithsej 9 klasë mësimi, bibliotekën, sallën e leximit, mesxhidin, dy kabinete të gjuhëve, fonolaborator, kabinetin e biologjisë me pajisjet e nevojshme, kabinetin e informatikës, librari, kafeterinë, sallën e arsimitarëve dhe zyrat e nevojshme për administratë.

- **Ndërtesa e konviktit** ku janë të vendosura 50 dhoma të fjetjes, 3 dhoma të aktiviteteve të lira, 3 dhoma të edukatorëve, banjat, stacionarin, nxemjen qendrore, lavatriçet dhe strehimorja në rast të ndonjë lufte.

- **Ndërtesa e kuzhinës** ku janë të vendosura salla e restorantit, kuzhina, depot për ushqimin, frigoriferin e mishit për 5 tonelata mish etj.

Krahas këtyre objekteve, në oborin e Medresesë gjendet fusha e sportit dhe furra e bukës me depon.

Medreseja ka statusin e shkollës së mesme, me mësim të orientuar. Që të realizojë objektivat për çka edhe është ndërtuar, Medreseja ka rregulloret e punës dhe sipas tyre, nxënësi detyrimisht vendoset në konviktin e shkollës, ndryshe nuk i jepet e drejta e shkollimit. Për këtë, Medreseja ka Rregulloren e Rendit shtëpiak ku përfshihet jeta 24 orëshe e nxënësit.

Brenda katër viteve sa zgjat shkollimi në medrese mësohen gjithsej 30 lëndë,¹⁴ ndër të cilat dhe pesë gjuhë: gjuha shqipe, maqedone, turke, gjuha arabe dhe angleze; mësohen lëndë fetare, si: kiraeti (mënyra e drejtleximit e Kur’ani kerimit), akaidi (besimi Islam), fikhu (jurisprudenca Islame), histroia Islame, ahlaku (etika Islame), tefsiri (rregullat e komentimit të Kur’ani kerimit), hadithi (rregullat dhe fjalët e traditës peygamberike), usuli fikh (bazat e jurisprudencës Islame), filozofia Islame, filozofi e përgjithshme, kultura dhe civilizmi Islam, pedagogji, psikologji, sociologji, histori,

¹⁴ Statutu i SHMI “MEDRESJA ISA BEU” – Shkup.

gjeografi, matematikë, informatikë, fizikë, kimi, metodikë, didaktikë dhe edukatë fizike.

Plan-programet e lëndëve shkencore, thënë kushtimisht meqë një ndarje e këtillë nuk ekziston dhe të gjuhëve i marrim nga Ministria e Arsimit dhe për të njëjtat shërbehemi me tekstet mësimore nga e njëjta Ministri.

Për sa u përket plan-programeve të lëndëve fetare, ato janë të përpiluara nga Komisioni i formuar me iniciativën e Bashkësisë Islame.¹⁵ Në bazë të plan-programeve, profesorët përgaditin librin, apo dispencën mësimore për lëndët përgjegjëse, që lirisht mund të thuhet se janë në nivel, gjë që mbështet përgaditjen profesionale të nxënësit të medresesë.

Për të realizuar procesin mësimor, në “Medresenë Isa Beu” është angazhuar numri adekuat i profesorëve në marrëdhënie të rregullt pune dhe bashkëpunorët e jashtëm për lëndët që nuk përmbushin normën e paraparë të orëve. Ndërsa për realizimin e Rendit shtëpiak në Medrese janë angazhuar edukatorët që kujdesen për procesin edukativ të nxënësit.

Krahas mësimin të rregullt nxënësit merren edhe me aktivitete të lira për çka edhe kemi formuar seksionet e ndryshme, si: seksioni i korit, seksioni i mevludit, seksioni letrar, seksioni i kiraetit, seksioni i dramës, këshilli redaktues i revistës së nxënësve të medresesë, seksioni i artizanateve dhe seksioni i sportit.

Biblioteka e nxënësve është mjaft e pasur me tituj librash dhe për momentin numëron mbi 4000 tituj me afro 8000 ekzemplarë në gjuhë të ndryshme.

Gjatë vitit shkollor seksionet e ndryshme përgaditin evenimente të caktuara sipas kalendarit islam apo kombëtar. Për këtë vlen të përkujtoj këtu se Medreseja tradicionalisht mban Mevludin tradicional me rastin e ditëlindjes së Muhamedit a.s., seksioni i korit dhe i mevludit shënon datat e caktuara historike, qofshin fetare apo kombëtare. Seksioni i sportit vazhdimisht merr pjesë në gara rajonale dhe më gjerë. Seksioni i kiraetit

¹⁵ Arkivi i Bashkësisë Islame dhe i Medresesë – Shkup.

merr pjesë në garat kur'anore që mbahen në Ballkan dhe më gjerë. Seksioni i artizanateve për të cilin dallohet dega e vajzave në Tetovë, tanimë në mënyrë tradicionale në fund të prillit, me rastin e ditëlindjes së Pejgamberit a.s. mban ekspozitën me karakter aukcional dhe të interesuarit mund të blejnë eksponatet që i pëlqejnë. Ndërkaq seksioni i grupit letrar zakonisht brenda vitit shkollor boton dy numra të gazetës së nxënësve me titullin "Ikre" – lexo.

Me përfundimin e shkollimit të rregullt në medrese, nxënësit kryesisht vazhdojnë shkollimin sipëror në universitete të vendit dhe jashtë Maqedonisë me theks të veçantë në Republikën e Turqisë dhe në botën arabe. Karakteristikë e nxënësve të medresesë është se gjer më tani janë të suksesshëm në studimet sipërore dhe tanimë kemi nxënës që kanë arritur gradat e larta të shkollimit deri në doktoraturë si dhe janë të punësuar në të gjitha sektorët shoqërore në Maqedoni dhe jashtë Maqedonisë.

Shtrirja e medresesë

Nisur nga nevoja e shkollimit të gjinisë femrore, Bashkësia Islame në vitin 2004 hapi degën e vajzave në Tetovë dhe kjo degë tanimë ka krijuar imazhin e saj në nivel shtetëror dhe ndërkombëtar. Krahas Degës së vajzave në Tetovë, si degë të shtrira të Medresesë, sot janë hapur: dega e shtrirë e vajzave në Gostivar, dega e vajzave në Shkup dhe dega e djemve në Shtip.

Sfidat me të cilat përballlet medresja sot

Me ndryshimet shoqëro-ro-politike, Bashkësia Islame, respektivisht Medreseja përballlet me etnocentrizmin e vet sipas së cilës e ka shumë vështirë të del jash kornizave autoritative. Nisur nga kjo, edhe medreseja has në pengesa organizative të cilat me sa duket e ka të pamundshme që të ndryshojë, sepse autoritetet e Bashkësisë Islame si themelues të medresesë, kanë frikën mos vallë do të humbasin prezencën e tyre për të mos thënë influencën e tyre që kanë në Medrese. Nisur nga kjo teori, Medreseja sot përballlet me:

1. Çështjen juridike të Medresesë,

Medreseja fatkeqësisht sot e kësaj dite nuk e ka të rregulluar çështjen juridike të statusit të saj. Këtë e mbështesim në problemet që u paraqiten nxënësve gjatë regjistrimit në universitete. Pra, regjistrimi i nxënësve në universitete ngel në disponimin e Ministrisë së Arsimit, respektivisht të vetë Ministrit, i cili duhet të vendosë nëse do të lejojë që nxënësit e medresesë të regjistrohen në universitet apo jo. Për këtë duhet të angazhohet politika, respektivisht koalicioni qeveritar. Pra, edhe pas 25 viteve, statusi juridik i Medresesë në Maqedoni ka ngelur në dëshirën e politikës, sepse nuk është zgjidhur në mënyrë juridike.

2. Çështja organizative.

Përkundër organeve udhëheqëse që Medreseja ka sipas akteve normative të Bashkësisë Islame, ajo vazhdon të punojë nën presione të natyrave të ndryshme. Kreu i Bashkësisë Islame vazhdimisht është autoriteti vendim-marrës edhe për çështjet më të imta të punës së medresesë, si p.sh.: pranimi i nxënësve në medrese kryesisht bëhet pas miratimit të kreut të BI-së edhe pse me këtë shkelen Rregulloret e Medresesë; punësimi i kuadrit arsimor bëhet nën terkun e afërsisë, klanit apo interesave të tjera të caktuara dhe nuk përfillet aftësia, bile as edhe shkollimi përkatës; aktivitetet që duhet të zhvillojë medreseseja kryesisht duhet të miratohen nga kreu i BI, pastaj medreseja mund të realizojë aktivitetin që e parasheh akti normativ, Statuti apo Rregullorja

3. Çështjet financiare.

BI është ajo që cakton buxhetin e Medresesë. Për këtë nuk ka kurrfarë dilemash, mirëpo, edhe pasi përcakton buxhetin, BI nuk e lë medresenë të lirë që të veprojë brenda kornizave dhe nevojave të veta, por për çdo imtësi duhet të merret leje nga kreu i BI.

Këtu mund të parashtroni pyetjen se pse nuk vepron Drejtori apo Këshilli Arsimor? Nuk mund të veprojë, sepse ardhmëria e tyre varet nga piramida e BI e nuk varet nga rezultatet e punës.

Përfundimi

Medresja është një vatër edukativo–arsimore e sigurtë në të gjitha kuptimet. Mirëpo, që të përmbushen objektivat për çka ajo është themeluar, mendoj se duhet të bëhet një riorganizim i këtyre enteve edukativo–arsimore sa më shpejt, përndryshe Medreseja do të ngelë vetëm si një sinonim i së mirës e në fakt nuk do mundë të përmbushë kërkesën e të rinjve të cilët i pret një kohë shumë dinamike, profesionale dhe me sfida të lloj–llojshme në kohën që do të jetojnë. Nëse BI nuk zgjohet që të përballojë këto sfida që tani, atëherë nesër do të bëhet shumë vonë.

(Referat i lexuar në Konferencën ndërkombëtare në Tiranë e organizuar nga **Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam (AIITC)** dhe **Instituti Ndërkombëtar i Mendimit Islam (IIIT)** respektivisht Tivar të Malit të Zi, tetor 2016.)